



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

P. nr. 823/17

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË-Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtarja **Ilijana Hoti**, me sekretaren juridike Flutur Nagavci, në çështjen penale kundër të akuzuarit **K.K.** nga Gj., për shkak të veprës penale vjedhje e shërbimeve nga neni 320 të KPRK-së, sipas Aktakuzës Prokurorisë Themelore-DP në Gjakovë, PP.nr.1361/17 të datës 29.11, 2017 në shqyrtimin fillestar të mbajtur më datë **23.04.2018**, prani të Prokurorit të shtetit Mone Sylja dhe të akuzuarit, mori dhe shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari **K.K.** nga Gj., i biri i R. dhe i nënës F. e gjinisë D., i lindur me dt. .. ne Gj., ka te kryer shkollën e mesme, i pa punë, i gjendjes se dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i R. Kosovës, i martuar at i 2 fëmijëve, me nr.....

Ë s h t ë f a j t o r:

Sepse :

-me date 19.04.2017, në Gj., në lokalit të tij me qëllim që vetit të sjellë përfitim pasuror në mënyrë të kundërligjshme në kundërshtim me dispozitën e Ligjit për energji elektrike të R. Kosovës, ka shfrytëzuar energjinë elektrike në atë mënyrë që gjatë kontrollit nga ana e zyrtarëve të KEDS-it, është konstatuar se jashtë njehsorit elektrik me nr.2, prapa tabelës përmes kabllor është kyçur në shfrytëzimin e energjisë elektrike direkt duke e shmangur lidhjen në njehsor elektrik dhe ajo rrymë e shpenzuar nuk është regjistruar, kështu me këtë ka shkaktuar dëm kompanisë KEDS- Divizioni i Rrjetit në Gjakovë, dem në shume prej 204.64 euro.

- me çka ka kryer veprën penale vjedhje e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPRK-së.

Andaj Gjykata në bazë të nenit 4,17,41,46,49,50,51,52 par.5, 73, neni 320 të KPRK-së dhe nenit 365 të KPP, të akuzuarës i shqipton :

DENIM ME KUSHT

Dënim me burgim në kohëzgjatje prej **3(tre) muajve** dhe dënim me gjobë në shumë prej **100.00 (njëqind) euro**, të cilat dënime nuk do të ekzekutohen nëse i akuzuari brenda kohës së verifikimit në afatin prej **1 (një) viti**, nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale.

E dëmtuara KEDS –Distrikti në Gjakovë për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohetb në kontest civil.

I akuzuari obligohet që në emër të shpenzimeve procedurale dhe ate ne emër te paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej **20 ,00 €**, në afat prej **15 ditëve**, pasi që Aktgjykimi të merr formë të prerë ,nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjakovë –Departamenti i Përgjithshëm , ka ngritë aktakuzën PP.nr.1361/2017 të 29.11.2017,të përmirësuar me dt. 06.03.2018, ndaj të akuzuarit K.K. nga Gj. , për shkak se ka kryer veprën penale vjedhje e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPRK-së, dhe ka propozuar që të akuzuarin ta shpallë fajtor dhe të gjykohet sipas Kodit Penal.

Me dt. 23.04.2018 është mbajtur shqyrtimi gjyqësor konform nenit 285 parg. 1 te KPP-ës, në të cilën janë ftuar te gjitha palët ndërsa shpallja e Aktgjykimit është bere me dt.23.04.3.2018.

Gjatë shqyrtimit fillestar me dt. 23.04.2018, përfaqësuesi i PTH-së në Gjakovë , Prokurorja Mone Syla lexoi aktakuzën PP.nr.1361/17 të dt. 29.11.2017dhe deklaroi se sa i përket dispozitivit te aktakuzës bene përmirësimin gjegjësisht pas fjalës nga ana e zyrtareve te KEDS-it duhet te jete “ është konstatuar se jashtë njehsorit elektrik me nr. 64665442 ,prapa tabelës është kyçur ne shfrytëzimin e energjisë elektrike direkt duke shmangur lidhjen ne njehsor elektrik” ndërsa pjesa tjetër mbetet e pandryshuar .

I akuzuari K.K. , gjate shqyrtimit fillestar duke u deklaruar lidhur me fajësinë theksoi se e pranon ne tërësi fajësinë sipas aktakuzës se përmirësuar dhe te plotësuar me te cilën pandehet duke i ditur edhe me pare pasojat e pranimi te fajësisë dhe atë ne mënyrë vullnetare dhe pa presion me qene se një gjendje e tillë është konstatuar nga punëtorët kompetent te KEDS-it, shtojë se me qene se njehsori elektrikë është i ç’ kyçur është e vërtet se një fazë e kam lidhur direkt ne siguresë te njehsorit te shtëpisë ,me të te çilen e shfrytëzojë duke mos ditur se jam duke kryer vepër penale ngase kam llogaritur se me një veprim te tillë nuk është i dëmshëm me qene se kam konsideruar se kjo regjistrohet ne njehsorin ekzistues ,andaj i propozoi gjykatës qe duke marr parasysh rrethanat lehtësuese si pranimi i fajësisë , premtimi se ne te ardhmen do te jem me i kujdesshëm dhe nuk do te përsëris një veprim te tillë , gjendjen e dobët ekonomike, si dhe faktin se me pare nuk kam ra ndesh me ligjin te me shqiptojë një dënim me te butë.

Duke u deklaruar lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit Prokurori i shtetit Mone Syla deklaroi se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë pasi qe i njëjti është i vetëdijshëm për pasojat dhe favoret juridike te pranimi te fajësisë dhe se aktakuza ka mbështetje ne provat materiale qe gjenden ne shkresat e lendes por sa i përket lartësisë se demit e dëmtuara te udhëzohet ne kontest civil me qene se nga shkresat e lendes nuk ka ndonjë ekspertizë me te cilën do te vërtetohej lartësia e energjisë se shpenzuar .

Ne shqyrtimin fillestar gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

Në tërësi u vërtetua se i akuzuari K.K. :- me date ..., në Gj. , në lokalitetin e tij me qëllim qe vetit ti sjellë përfitim pasuror në mënyrë të kundërligjshme në kundërshtim me dispozitën e Ligjit për energji elektrike të R. Kosovës ,ka shfrytëzuar energjinë elektrike ne atë mënyrë qe gjatë kontrollit nga ana e zyrtarëve të KEDS-it , është konstatuar se jashtë njehsorit elektrik me nr.2 , prapa tabelës përmes kabllor është kyçur në shfrytëzimin e energjisë elektrike direkt duke e shmangur lidhjen në njehsor

elektrik dhe ajo rrymë e shpenzuar nuk është regjistruar , kështu me këtë ka shkaktuar dëm kompanisë KEDS- Divizioni i Rrjetit ne Gjakovë , dem ne shume prej 204.64 euro .

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar nga vet pranimi i fajësisë nga i akuzuari i cili ne shqyrtimin fillestar vullnetarisht ka pranuar fajësinë ,për shkak te se cilës gjykata nuk ka administruar provat ,gjykata ka ardhur ne përfundim se pranimi i fajësisë nga i akuzuari është bere ne pajtim me nenin 248 te KPPK-ës. Gjate pranimit te fajësisë gjyqtari i vetëm gjykues konstatojë se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit te fajësisë ,pranimi është bere vullnetarisht nga i akuzuari, pranimi i fajësisë mbështetet ne faktet dhe provat qe i përmban aktakuza ,në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje te qarte ligjore ose gabime faktike .

Gjykata nga te cekurat me lartë ka ardhur ne përfundim se ne veprimet e te akuzuarit formohen te gjitha elementet e veprës penale te përshkruara si ne dispozitiv te këtij aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur qe te akuzuarin ta shpalle fajtor dhe ta gjykojë ne bazë te ligjit ,me pare duke vërtetuar përgjegjësisë penale juridike te tij.

Me rastin e matjes së dënimit ,gjykata ka pasur parasysh të gjitha rrethanat nga neni 73 të KPRK-së, të cilat ndikojnë në zbutjen apo ashpërsimin e dënimit .Rrethana rënduese nuk gjeti ndërsa si rrethana lehtësuese gjykata ka vlerësuar rrethanat personale të akuzuarit se është baba i 2 fëmijëve, pranimin e vullnetshëm të fajësisë nga i akuzuari, sjelljen korrekte të akuzuarit në gjykim, pendimin e tij, premtimin se ne te ardhmen nuk do te kryej veprat e tilla , si dhe faktin se më parë nuk ka qenë i dënuar nga ana e gjykatës . Kështu që duke mos gjetur rrethana rënduese Gjykata të akuzuarit i shqiptoi dënim me burgim në kohëzgjatje prej 3(tre) muajve dhe dënim me gjobë prej 100,00(një qind) euro me kushte qe ne afatin prej 1(një) viti te mos kryej ndonjë vepër tjetër penale, me bindje se edhe me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë nga neni 41 dhe 50 të KPRK-së dhe ky dënim i tillë i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari.

Vendimi për udhëzimin e palës se dëmtuar ne kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore juridike është marr bazuar ne nenin 463par.3 te KPP-ës.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushalli gjyqësor bazohet në dispozitat e nenit 450 par.1dhe 2 nën paragrafi 2.6 te KPPK-së.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi .

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË,
P. nr.823/17 më datë 23.04.2018.**

**Sekretarja juridike,
Flutur Nagavci**

**G j y q t a r j a,
Ilirjana Hoti**

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi mund te paraqitet ankesë, në afatin prej **15 ditësh** ,nga dita e marrjes se tij ne dorëzim ,Gjykatës së Apelit ne Prishtinë. Ankesa ne kopje te mjaftueshme i dorëzohet kësaj Gjykate.

Numri i lëndës: 2018:012261
Datë: 27.04.2018
Numri i dokumentit: 00030892